

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6138
E mërkurë, 14 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Fillon ndarja e 60-milionëshit për bizneset



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ

SUKSESI I KËSAJ QEVERIE, AFTËSIA PËR TË MBIJETUAR

Politologu Belul Beqaj ka vlerësuar se qeveria Hoti nuk ka ndërmarrë veprime për t'u dhënë përgjigje kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se në aspektin strukturor të brendshëm vendi është para kolapsit, kurse në aspektin e jashtëm zotimet e marrëveshjes së

Washingtonit lënë për të dëshiruar. Beqaj ka deklaruar se sukcesi i kësaj qeverie është aftësia për të mbijetuar. Ai e ka kritikuar edhe opozitën. Sipas Beqajt, sjelljet e opozitës ia kanë mundësuar mbijetesën kësaj qeverie pavarësisht prej faktit se shumica absolute e qytetarëve është e pakënaqur me qeverisje



OPINION

JO PARAMILITARË DHE JO MASAKRA

Nga Jakup KRASNIQI



AKTUALE



MINISTRI ZEMAJ BËN THIRRJE QË TË RESPEKTOHEN MASAT KUNDËR COVIDIT

PARKINGU NËNTOKËSOR TEK UP-JA DO TË PËRFUNDOJË PAS ZGJEDHJEVE KOMUNALE

ZAFIR BERISHA: QYTETI I PRIZRENIT ËSHTË KAPLUAR NGA QEVERISJA E KEQE E LV-SË

EKONOMI




OAK-U I PREZANTON KRYETARES SË KUVENDIT GJENDJEN E RËNDË TË BIZNESIT

GJATË PANDEMISË JANË BËRË 78 MIJË KËRKESA PËR SHTYRJE TË KËSTIT TË KREDISË

SPORT

BERISHA, ZENELI DHE ZHEGROVA MUNGOJNË NË NDESHJEN NDAJ GREQISË



TRAGJEDI SHQIPTARE NË GJERMANI, PAS GODITJES NGA TRENI, VDESIN DY VËLLEZËR NGA DEÇANI

Dy vëllezër, njëri 13 vjeç dhe tjetri 17 vjeç nga Komuna e Deçanit, fshati Ratish i Epërm, banorë të Gjermanisë, kanë vdekur mëngjesin e së martës në Bruckberg afër Mynhenit, pas goditjes

nga treni. Ata po tentonin që ta zënin trenin i cili ishte në stacion dhe vrapuan drejt shinave, por u goditën nga një tren që po vinte drejt Mynhenit dhe lëndimet e marra ishin fatale pas goditjes.

Familjes Arifaj nga Ratishi i Epërm i Deçanit i kanë shprehur ngushëllime përfaqësues të Kosovës nga niveli qendror dhe lokal, duke bashkëndier dhimbjen me këtë familje



HOTI, PAS TAKIMIT ME LAJÇAKUN: NUK KA ASOCIACION ME KOMPETENCA EKZEKUTIVE

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Tragjedi shqiptare në Gjermani, pas goditjes nga treni, vdesin dy vëllezër nga Deçani

Dy vëllezër, njëri 13 vjeç dhe tjetri 17 vjeç nga Komuna e Deçanit, fshati Ratish i Epërm, banorë të Gjermanisë, kanë vdekur mëngjesin e së martës në Bruckberg afër Mynhenit, pas goditjes nga treni. Ata po tentonin që ta zënin trenin i cili ishte në stacion dhe vrapuan drejt shinave, por u goditën nga një tren që po vinte drejt Mynhenit dhe lëndimet e marra ishin fatale pas goditjes. Familjes Arifaj nga Ratishi i Epërm i Deçanit i kanë shprehur ngushëllime përfaqësues të Kosovës nga niveli qendror dhe lokal, duke bashkëndier dhimbjen me këtë familje



“Epoka e re”

PRISHTINË, 13 TETOR - Dy vëllezër, njëri 13 vjeç dhe tjetri 17 vjeç nga Komuna e Deçanit (fshati Ratish i Epërm), banorë të Gjermanisë, kanë vdekur mëngjesin e së martës në Bruckberg afër Mynhenit, pasi

janë goditur nga treni. Të dy të rinjtë po tentonin që ta zënin trenin i cili ishte në stacion dhe vrapuan drejt shinave, ku u goditën nga një tren që po vinte drejt Mynhenit dhe lëndimet e marra ishin fatale pas goditjes. Një zëdhënës i policisë në Bruckberg ka thënë se drejtuesi i trenit donte të fillonte një

frenim emergjentë, por ishte tepër vonë.

Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka ngushëlluar familjen Arifaj nga kjo komunë, duke thënë se Deçani është tronditur rënd nga kjo tragjedi që ndodhi në Bruckberg. “Për Deçanin dhe qytetarët e Deçanit është rast i

rëndë dhe ditë e zezë tragjedia që i ndodhi familjes Arifaj nga Ratishi i Epërm i kësaj komune. Ngushëllime familjes dhe të gjithë qytetarëve për këtë rast tejet të rëndë”, ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Për këtë rast ka reaguar edhe kryeministri Avdullah Hoti. “Jam thellësisht i tronditur nga lajmi për vdekjen e dy të rinjve kosovarë në Gjermani. Autoritetet kosovare tashmë janë në kontakt me ato gjermane për t’i sqaruar rrethanat e këtij rasti, ku dy vëllezër, 13 dhe 17 vjeç, humbën jetën tragjikisht. Në emër të Qeverisë së Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes”, ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në “Facebook”.

Edhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka shprehur ngushëllime pas vdekjes së dy vëllezërve nga Deçani në rrethana tragjike, pas goditjes nga treni në Gjermani.

Ajo ka bërë me dije se Ambasada e Kosovës në Berlin dhe Konsullata e Përgjithshme në Bavari janë në kontakt me autoritetet gjermane. “Me rastin e vdekjes tragjike të personave B. A. dhe H. A. (13 dhe 17-vjeçar) në Gjermani, Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Republikës së Kosovës shpreh ngushëllimet më të sinqerta për prindërit e familjarët, si dhe qytetarët e Deçanit dhe Kosovës. Ambasada e Kosovës në Berlin dhe Konsullata e Përgjithshme në Bavari janë në kontakt me autoritetet gjermane për t’u sqaruar kjo tragjedi e rëndë. Jeta jashtë vendlindjes në këto rrethana di të jetë shumë e rëndë dhe jemi duke bërë çdo gjë që familjes t’i gjendemi pranë në këto çaste të vështira”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e saj në “Facebook”. Familjes Arifaj nga Ratishi i Epërm i kanë shprehur ngushëllime edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj.



Ambasadori Dedaj: Ka ardhur koha e liberalizimit të vizave për Kosovën

SHKUP, 13 TETOR (ER) - Ambasadorja e Suedisë në Shkup, Kristin Forsgren Bengtsson, ka pritur në rezidencën e saj, Gjergj Dedajn, ambasador i Republikës së Kosovës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ambasadori Dedaj e ka njoftuar diplomatën e Suedisë me zhvillimet politike në Kosovë, duke ritheksuar se duhet të

shtohet perspektiva evropiane dhe procesi i integrimit euroatlantik i Kosovës dhe i të gjitha vendeve të rajonit. Dedaj ka ritheksuar se ka ardhur koha e liberalizimit të vizave dhe se është imediate që vendet e BE-së të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, këtë duhet ta bëjnë sa më parë ngaqë, sipas tij, kjo i kontribuon përmblylljes së

negociatave dhe njohjeve reciproke të Kosovës dhe Serbisë.

Ndërkaq ambasadorja e Suedisë ka ritheksuar se vendi i saj dhe shtetet anëtare të BE-së duan të shohin përparim demokratik, përmbushje të standardeve të BE-së dhe të hapet mundësia e integrimit evropian për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.



Ministri Zemaj bën thirrje që të respektohen masat kundër Covidit

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka kërkuar të martën që Policia e Kosovës dhe të gjitha inspektoratet pa dallim, bashkë me komunat dhe shtabet emergjente, të veprojnë urgjentisht për parandalimin e përkeqësimit të situatës me Covid-19. Ai ka bërë thirrje që të respektohen masat kundër Covidit. Ai ka bërë me dije se nga sot (e mërkurë) do të jenë në terren edhe 75 inspektorë sanitarë, ndërsa nga Policia e Kosovës do të kërkojë kthim të orarit të punës nga 12 orë në ditë



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se masat kundër Covidit duhet të respektohen nga çdokush dhe në çdo kohë. Ai ka kërkuar të martën që Policia e Kosovës dhe të gjitha inspektoratet pa dallim, bashkë me komunat dhe shtabet emergjente, të veprojnë urgjentisht për parandalimin e përkeqësimit të situatës. "Inspektimet do të vazhdojnë me ritëm të shtuar, gjatë të shqiptohen sipas Ligjit për luftimin e pandemisë Covid-19 dhe nuk do të lejohet asnjë lloj shkarje prej ligjit, i cili duhet të zbatohet me përpikëri", është shprehur ai. Ministri Zemaj ka thënë se

nga e mërkura do të jenë në terren edhe 75 inspektorë sanitarë, ndërsa nga Policia e Kosovës do të kërkojë kthim të orarit të punës nga 12 orë në ditë. "Tash, kur gastronomia mund të punojë edhe brenda hapësirave të lokaleve të veta, distanca në mes të tavolinave, higjiena dhe mbajtja e maskave si nga personeli, po ashtu edhe nga mysafirët, janë të domosdoshme. Aty ku ka neglizhencë, aty ku vazhdohet me dasma dhe tubime të tjera familjare, aty do të ketë mbyllje, pa paralajmërim, në të kundërtën masat e reja do të jenë të domosdoshme", është shprehur Zemaj. Ai ka shtuar se tashmë kur lakorja e infeksionit po rritet në Evropë dhe botë, dhe kur masat e mbylljes dhe karantina po kthehen në ato vende me risk

të lartë të infeksionit, ne si Kosovë nuk guxojmë t'i lëmë rastit asgjë. "Kjo është një sfidë e madhe që na takon të gjithëve dhe të gjithë së bashku do t'ia dalim", ka deklaruar ministri Zemaj.

98 raste të reja me Covid-19

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 685 mostra të marra

nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 98 raste pozitive. Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes me Covid pozitiv (1 rast Spitali Gjakovë). Numri total i rasteve pozitive është 16 345 raste nga 75 973 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 649 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 37 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 405 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 291.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 37 raste, komuna Vushtrri 10 raste, komuna Drenas 9 raste, komuna Deçan 6 raste, komuna Mitrovicë 6 raste, komuna Fushë-Kosovë 4 raste, komuna Gjilan 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Malishevë 3 raste, komuna Ferizaj 2 raste, komuna Podujevë 2 raste dhe me nga një rast komunat Hani i Elezit, Istog, Kamenicë, Klinë, Pejë, Shtime, Skenderaj dhe Suharekë.

Këtë të premte Kuvendi do t'i mbajë dy seanca plenare

EPOKA ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 13 TETOR - Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e së martës, të drejtuar nga kryetarja Vjosa Osmani, vendosi që të premten, më 16 tetor, në orën 10:00, Kuvendi t'i vazhdojë punimet me pikat e mbetura nga seancat e kaluara.

Ndërkaq në orën 11:00, në të po të njëjtën ditë, Kuvendi do të mbledhet në seancë të re plenare, në të cilën, pas ezaurimit të deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, do të shqyrtohen disa projektligje: Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e programit - nxitja dhe levimi i mundësive për sigurimin e ujit; Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës - instrumenti për



financim të sektorit publik për reagim emergjent ndaj Covid-19; Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për likuiditet të urgjencës së infrastrukturës vitale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe Projektligji për ratifikimin e Kontratës Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Impiantit të Ujërave të Zeza në

Gjilan. Në shqyrtim të parë do të shqyrtohen tri projektligje: Projektligji për Peticione, Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë dhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122 si dhe Ligjin nr. 003/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në

Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256. Në këtë seancë Kuvendi në shqyrtim të parë do ta shqyrtojë edhe Projekt Kodin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2019. Po në këtë seancë plenare pikë e rendit të ditës do të jetë edhe emërimi i gjashtë anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas dhe zgjedhja e tre

anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave. Në këtë mbledhje, me rekomandim të Komisionit për Buxhet dhe Transfere, kryesia miratoi kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2021 në bazë të qarkores së dytë buxhetore të Ministrisë së Financave 2021/02, si dhe raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2020.



Flet për “Epokën e re”, Belul Beqaj

SUKSESI I KËSAJ QEVERIE, AFTËSIA PËR TË MBIJETUAR

Politologu Belul Beqaj ka vlerësuar se qeveria Hoti nuk ka ndërmarrë veprime për t’u dhënë përgjigje kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se në aspektin strukturor të brendshëm vendi është para kolapsit, kurse në aspektin e jashtëm zotimet e marrëveshjes së Uashingtonit lënë për të dëshiruar. Beqaj ka deklaruar se sukseksi i kësaj qeverie është aftësia për të mbijetuar. Ai e ka kritikuar edhe opozitën. Sipas Beqajt, sjelljet e opozitës ia kanë mundësuar mbijetesën kësaj qeverie pavarësisht prej faktit se shumica absolute e qytetarëve është e pakënaqur me qeverisje

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 TETOR - Politologu Belul Beqaj ka kritikuar punën e deritashme të qeverisë Hoti. Ai ka deklaruar se kjo qeveri as në planin e jashtëm dhe as në atë brendshëm nuk iu ka dhënë përgjigje nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Beqaj ka thënë se sukseksi i kësaj qeverie është aftësia për të mbijetuar. “Sukseksi i kësaj qeverie është aftësia e mbijetesës. Përndryshe, në planin e brendshëm dhe të jashtëm nuk mund të veçojmë veprime të cilat kanë dhënë përgjigje për kërkesat, interesat dhe nevojat e qytetarëve. Në aspektin

strukturor të brendshëm jemi para kolapsit”, ka deklaruar Beqaj.

Ai i ka kritikuar edhe subjektet opozitare. Sipas tij, opozita nuk po luan rolin që i takon dhe në këtë mënyrë po ia zgjatë jetën kësaj qeverie. Beqaj ka vlerësuar se pret që pakënaqësia e shtresuar ndër vite e qytetarëve do të nxisë zgjedhje të reja në vend. “Sjelljet e opozitës ia kanë mundësuar mbijetesën qeverisë përkundër faktit se shumica absolute e qytetarëve është e pakënaqur me qeverisje. Unë pres që pakënaqësia e shtresuar ndër vite, që po kulmon me keqqeverisje aktuale, do t’i nxisë zgjedhjet si mundësi e ndryshimit të politikëbërjes

dhe të politikanëve”, është shprehur ai.

Duke folur për mungesën e konsensusit në mes të pozitës dhe opozitës për çështje nacionale, ai ka thënë se raportet e ndërsjella të subjekteve politike janë të ndotura. “Përkundër faktit se kemi më shumë subjekte politike sesa që kemi nevojë, Kosova ka nevojë për freski politike që nuk ndikohet nga ndotjet e ndërsjella të kultivuara ndër vite, veçmas të partive që kanë qenë dhe janë në pushtet dhe si arsye të vetme të bashkëpunimit e kanë interesin pavarësisht se njëra-tjetrën nuk dëshirojnë të shohin me sy?!”, është shprehur ai, duke shtuar se duhet mbështetur mocioni i



mosbesimit i cili është iniciuar kohë më parë nga Lëvizja Vetëvendosje. “Prandaj, për të mos dëmtuar qytetarët dhe Kosovën në vazhdimësi, krahas faktit se duhet mbështetur mocioni i LV-së për rrëzimin e qeverisë, duhet menduar edhe për krijimin e alternativës së modelit të deritanishëm të qeverisjes, të cilit mund t’i ndihmojë një subjekt i ri politik”, ka thënë Beqaj.

“Epoka e re”: Z. Beqaj, cili është vlerësimi juaj për punën e deritanishme të qeverisë Hoti?

Beqaj: Suksesi i kësaj qeverie është aftësia e mbijetesës. Përndryshe, në planin e brendshëm dhe të jashtëm nuk mund të veçojmë veprime të cilat kanë dhënë përgjigje për kërkesat, interesat dhe nevojat e qytetarëve. Në aspektin strukturor të brendshëm jemi para kolapsit, në aspektin e jashtëm marrëveshjet e Uashingtonit janë zotime të cilat lënë për të dëshiruar, të cilat kanë thelluar divergjencën me BE-në dhe zgjidhjen definitive edhe pse po tentohet të “shitet” si “sukses historik”.

“Epoka e re”: Sfidat kryesore të kësaj qeverie deri më tani kanë qenë menaxhimi i pandemisë dhe procesi i dialogut me Serbinë. Si e keni parë qasjen e qeverisë ndaj këtyre dy sfidave?

Beqaj: Realisht kjo qeveri është krijuar me paramendim se procesin e dialogut me Serbinë do ta përfundojë sipas skenarit të administratës amerikane, i

cili, pas rezistencës së brendshme dhe të jashtme, e ndryshoi synimin e paralajmëruar me pompozitet për njohje reciproke dhe rrëshqiti në “normalizim të marrëdhënieve ekonomike?!”. Së dyti, menaxhimi i çështjes së pandemisë është më shumë jashtë ndikimit qeveritar sesa pasojë e menaxhimit qeveritar. Fati është se fillimisht është trasuar rruga e duhur në luftën kundër pandemisë gjatë qeverisjes LV-LDK, përkatësisht Arben Vitisë e cila më shumë po vazhdon me inercion sesa me menaxhim.

“Epoka e re”: Po opozita është duke e luajtur rolin që i takon ndaj qeverisë?

Beqaj: Jo. Sjelljet e opozitës ia kanë mundësuar mbijetesën qeverisë përkundër faktit se shumica absolute e qytetarëve është e pakënaqur me qeverisje. Unë pres që pakënaqësia e shtresuar ndër vite, që po kulmon me keq-qeverisje aktuale, t’i nxisë zgjedhjet si mundësi e ndryshimit të politikëbërjes dhe politikanëve.

“Epoka e re”: Siç po shihet edhe në këtë legjislaturë nuk kemi ndonjë konsensus të pozitës dhe të opozitës për temat nacionale. A po dëmtohet Kosova nga mungesa e këtij konsensusi?

Beqaj: Raportet e ndërsjella të subjekteve politike janë të ndotura. Përkundër faktit se kemi më shumë subjekte

politike sesa që kemi nevojë, Kosova ka nevojë për freski politike që nuk ndikohet nga ndotjet e ndërsjella të kultivuara ndër vite, veçmas të partive që kanë qenë dhe janë në pushtet dhe si arsye të vetme të bashkëpunimit e kanë interesin pavarësisht se njëra-tjetrën nuk dëshirojnë ta shohin në. Prandaj, për të mos dëmtuar qytetarët dhe Kosovën në vazhdimësi, krahas faktit se duhet mbështetur mocioni i LV-së për rrëzimin e qeverisë, duhet menduar edhe për krijimin e alternativës së modelit të deritanishëm të qeverisjes, të cilit mund t’i ndihmojë një subjekt i ri politik.

“Epoka e re”: Partnerët e koalicionit qeverisës nga distanca kanë filluar ta diskutojnë çështjen e presidentit. Pritni që kjo çështje mund ta lëkundë koalicionin qeverisës dhe ta çojë vendin drejt zgjedhjeve të reja?

Beqaj: Fatkeqësisht presidenti është shndërruar si karrem zgjedhor dhe instrument i kalkulimeve politike. LDK-ja, përkatësisht Isa Mustafa, që e ka aktualizuar këtë para kohës, sot po thotë se nuk është koha të aktualizohet çështja e presidentit. Është koha që presidenti të zgjidhet me procedurë demokratike të drejtpërdrejtë ngaqë kështu si është, në vend se të jetë simbol i unitetit dhe stabilitetit, ai po paraqitet në rolin e pengesave dhe përçarjes politike.

Hoti, pas takimit me Lajçakun: Nuk ka asociacion me kompetenca ekzekutive

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se nuk do të ketë asociacion të komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive. Në një konferencë për media, pas takimit me përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, Hoti ka thënë se asociacioni do të jetë ashtu siç ka thënë Gjykata Kushtetuese. “Asociacioni është temë e mbyllur. Kemi garancitë që asociacioni nuk ka kompetencë ekzekutive. E kemi hequr nga tavolina idenë e shkëmbimit të territoreve, nuk flet askush më për këtë temë. Nuk diskutohet karakteri unitar i shtetit. Nuk kam ndërruar mendje dhe nuk kam kurrfarë presioni. Jam në detyrë për ta kryer punën si kryeministër i vendit në përputhje me Kushtetutën e vendit”, ka thënë Hoti. Ai ka deklaruar se Qeveria e Kosovës nuk është nën presion

për këtë çështje. “Nuk është qeveri që pranon kërcënime nga askush. Kemi marrëveshje koalicioni me të gjithë partnerët, përfshirë edhe Listën Serbe. Për aq kohë sa iu përmbahemi marrëveshjeve punojmë bashkë. Kjo është ajo që mund të them për këtë”, ka thënë Hoti. Ai ka përsëritur edhe një herë parimet e këtyre bisedimeve. “Po diskutojmë për marrëveshjen finale, që nënkupton njohje reciproke. Vlen parimi me partnerët tanë dhe ndërmjetësues të dialogut: nuk pajtohemi për asgjë derisa nuk pajtohemi për të gjitha. Asgjë nuk zbatohet derisa nuk përmbillet marrëveshja përfundimtare me njohje reciproke të ratifikuar në Kuvend. Tek atëherë fillon zbatimi”, është shprehur ai. Kryeministri Hoti ka shtuar se vizita e Lajçakut është në momentin e duhur për të bërë një vlerësim për procesin e dialogut, si dhe për të bërë plane



për takimet e ardhshme që do të jenë në kuadër të këtij procesi. “Kosova nuk është palë që e bllokon procesin e dialogut. Kosova, ndoshta për herë të parë pas shumë kohësh, është palë jo

vetëm konstruktive, por protagoniste kryesore drejt marrëveshje përfundimtare për njohje reciproke. Është arritur pajtimi ndërkombëtar që të ulemi në tavolinë të dialogut

vetëm për një gjë, për marrëveshje përfundimtare”, ka thënë Hoti. Pas takimit me Hotin, Lajçaku është takuar të martën edhe me kryetaren e Kuvendit, Vjosa Osmani.

Selimi: Roli i shtetit shqiptar, i pazëvendësueshëm për avancimin e proceseve në vend

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Ministri Selimi gjatë këtij takimi ka vlerësuar angazhimin e ambasadorit Minxhozi si dhe ka shprehur mirënjohjen e tij për vëmendjen dhe besnikërinë me të cilën ndër vite shteti shqiptar e ka shoqëruar Kosovën. Në takim u diskutua për bashkëpunimin e ngushtë dypalësh dhe shtimin e aktiviteteve me interes për të dyja vendet, me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara nga dy qeveritë. Ministri Selimi, po ashtu,

theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë në Shqipëri, në funksion të fuqizimit të sundimit të ligjit dhe çdo hallkë tjetër të sistemit të drejtësisë. Me këtë rast, ministri Selimi e ka njoftuar ambasadorin Minxhozi për ecurinë e reformave në drejtësi, për agjendën legjislative si dhe për nismat e tjera, përfshirë procesin e llogaridhënies dhe vettingut.

Ambasadori Minxhozi e ka falënderuar ministrin Selimi për bashkëpunimin e ofruar dhe ka shprehur gatishmërinë për të përkrahur çdo nismë e cila është në funksion të konsolidimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë.



Manaj vlerëson rolin e Mbretërisë së Bashkuar në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur



PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Kryesuesi i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Ramë Manaj, me bashkëpunëtorë, ka pritur të martën në takim Edward Lister, sekretar i dytë politik dhe udhëheqës për politikë të jashtme në Ambasadën Britanike në Kosovë. Bashkëbiseduesit vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe mbështetjen e vazhdueshme të Ambasadës Britanike për Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe

procesin e zbulimit të fatit të personave të pagjetur.

Gjatë takimit u diskutuan edhe mundësitë e vazhimit të bashkëpunimit me theks të veçantë për implementimin e dy projekteve që përkrahen nga Mbretëria e Bashkuar, projektin në nivel rajonal për rritjen e bashkëpunimit mes komisioneve të shteteve të rajonit në zbatim të Deklaratës për Persona të Zhdukur, të nënshkruar gjatë Samitit të Londrës si dhe projektin në nivel nacional për përkrahje të

institucioneve të Republikës së Kosovës të angazhuara në këtë proces.

Kryesuesi i Komisionit, duke vlerësuar dhe shprehur falënderimin për rolin e Mbretërisë së Bashkuar në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur, shprehu edhe gatishmërinë për vazhdimin e mëtejme të bashkëpunimit në përpjekjen institucionale që familjet e personave të zhdukur të mësojnë sa më parë fatin dhe vendndodhjen e familjarëve të tyre të zhdukur.

Ministri Likaj: Do të jemi shumë të kujdesshëm për shpenzimin e parasë publike

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka miratuar Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për vitin 2019. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, është zotuar se do të jenë shumë të kujdesshëm për shpenzimin e parasë publike. "Çështja e klasifikimit të shpenzimeve është adresuar. Po ashtu edhe çështja e

mangësisë për rregullimin e sistematizimit të pozitave të punës. Ndërkaq çështja e marrëveshjes së shërbimeve të veçanta është ndërprerë dhe nuk është vazhduar. Ne jemi duke punuar vazhdimisht për t'i zbatuar të gjitha rekomandimet që janë nxjerrë nga raporti i ZKA-së. Do të jemi shumë të kujdesshëm për shpenzimin e parasë publike", ka shtuar ministri Likaj. Deputeti i AAK-së, Ali Berisha,

ka thënë se raporti i auditimit për këtë ministri është shqetësues. Ai ka thënë se këto parregullsi mund të adresohen në prokurori por, sipas tij, duhet vullnet nga udhëheqësit e MASH-it. "Raporti i kësaj ministrie është shumë shqetësues dhe ka shumë gjetje. Këto gjetje ka vend që mund të adresohen në prokurori dhe nëse këta e kanë vullnetin, mund t'i zgjedhin këto", ka thënë Berisha.



Hoti priti në takim njoftues atasheun e ri ushtarak nga ShBA, Stephen Rose



PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur në takim njoftues atasheun e ri ushtarak nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kolonel Stephen Rose, ku të pranishëm ishin edhe ministri i Mbrojtjes,

Anton Quni dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneraljejtënant Rrahman Rama. Me këtë rast, kryeministri Hoti, duke i uruar mirëseardhje kolonelit Rose, nënvizoi faktin se bashkëpunimi bilateral është tepër i rëndësishëm për

avancimin e mëtutjeshëm të aspiratave të FSK-së, e cila mbetet e përkushtuar që të jetë ndërvepruese me ushtritë mike dhe e integruar në NATO, ndihmën e së cilës Kosova nuk e harron kurrë dhe e çmon përherë. Në anën tjetër, koloneli Rose,

duke e vlerësuar kryeministrin Hoti për mirëpritjen, ndër të tjera, tha se është kënaqësi që ta japë kontributin e tij në Kosovë, duke u përkushtuar për thellim të bashkëpunimit të mëtejme dhe me interes reciprok.

Zafir Berisha: Qyteti i Prizrenit është kapluar nga qeverisja e keqe e LV-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRIZREN, 13 TETOR - Kryetari i Degës së Nismës Socialdemokrate në Prizren, Zafir Berisha, në një konferencë për media ka bërë me dije se ka filluar mbajtjen e kuvendeve zgjedhore nëpër nëndegë ku, sipas tij, deri në fund të muajit tetor të përfundojë ky proces.

Berisha ka thënë se në javën e parë të muajit nëntor pritet të mbahet kuvendi i degës, nga ku do të dalin strukturat e reja të Nismës Socialdemokrate në Prizren. "Nisma fton të gjithë qytetarët e Prizrenit, në veçanti intelektualët e rinj, që t'i bashkohen sot frymës socialdemokrate të Nismës, në mënyrë që nesër të jenë pjesë e ndryshimeve pozitive për Prizren dhe Kosovë", ka thënë ai.

Berisha ka kritikuar qeverisjen lokale në Prizren të drejtuar nga Mytaher Haskuka. "Nisma Socialdemokrate në Prizren shprehet e shqetësuar që qyteti i Prizrenit është kapluar nga qeverisja e keqe e LV-së dhe partnerët minoritarë të saj, të cilët çdo ditë po e degradojnë qytetin tonë me afera të ndryshme korruptive duke u treguar edhe shumë të paafte, për të cilën edhe raportet e MPL-së dhe të USAID-it tregojnë se qeverisja e Mytës dhe LV-së kanë treguar performancë të dobët në arsimin parauniversitar, infrastrukturë, kulturë, sport etj", ka thënë Berisha.

Ai ka theksuar se: "Në zgjedhjet e fundit lokale vërtet u mendua se erdhi dita e qytetarëve por, në fakt, koha po tregon se erdhi dita e kusarëve dhe hajdutëve të rinj të LV-së dhe komisarëve politikë të

cilët po e degradojnë gjithnjë e më shumë Prizrenin në emër të ligjit dhe rregullave siç është rasti i janarit të vitit 2019, në emër të ligjit për Zonën Historike të Prizrenit u hoqën ndërtimet me konstruksione metalike nga shumë biznese hotelierie, të cilëve iu shkaktuan dëme të mëdha financiare, e të cilët pas disa javësh përsëri kthyen të njëjtat ndërtime, pa qenë në dijeni askush se pse u hoqën dhe pse përsëri u vendosën po të njëjtat konstruksione metalike", ka deklaruar kryetari i degës së Nismës Socialdemokrate në Prizren, Zafir Berisha. Ai ka shtuar se ndërtimet pa leje, mbindërtimet, papastërtia, derdhja e ujërave të zeza në Lumbardhë, shkatërimi i shumë shtëpive me karakter historik në zonën historike qëpo e karakterizojnë keqqeverisjen e LV-së në Prizren.

Kosova nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore në rast të ndonjë fatkeqësie të madhe natyrore

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 TETOR - Me rastin e 13 Tetorit, Ditës Botërore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, njohësi i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), Tahir Ahmeti, ka theksuar se qëllimi i shënimit të kësaj dite e cila shënohet në të gjithë botën është vetëdijesimi i njerëzve për masat që duhet t'i marrim për zvogëlimin e rrezikut ndaj katastrofave të ndryshme. "Fatkeqësitë natyrore janë të paparashikueshme, me intensitete dhe efekte të ndryshme, të cilat mund të godasin çdo moment, duke

shkaktuar humbje të konsiderueshme të jetëve të njerëzve dhe të mirave materiale. Republika e Kosovës, në rast të ndonjë fatkeqësie më të madhe natyrore, edhe pse ka një kuadër të konsoliduar ligjor, plane dhe strategji të miratuara, kur jemi te gjendja aktuale në terren, nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, logjistike dhe operacionale, trajnime dhe ushtrime të mjaftueshme, si dhe pajisje dhe mjete të duhura për të reaguar në këso situata", ka thënë ai.

Ahmeti ka theksuar se është e domosdoshme ngritja e kapaciteteve. Ai ka thënë se duhet të ketë ndarje më të madhe të mjeteve financiare për investime. "Janë më së të nevojshme trajnimet, planet dhe përgatitjet në



vazhdimësi, ndërsa ushtrimet praktike të koordinuara të të gjitha institucioneve kompetente janë

mënyra më e mirë për të qenë sa më të gatshëm dhe më të përgatitur për t'i përballuar

fatkeqësitë e mundshme natyrore", ka deklaruar Tahir Ahmeti, njohësi i çështjeve të emergjencave.

Reforma e administratës publike, një nga proceset kyçe për agjendën evropiane të Kosovës



PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Në takim të Grupit të Veçantë të Reformës së Administratës Publike i cili është mbajtur të martën është biseduar për të arriturat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në linjë me zhvillimin e reformave të administratës publike. Zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, gjatë këtij takimi ka theksuar se ekziston një vullnet i fortë politik për të përmblytur një reformë, e cila do ta normojë hierarkinë

institucionale të institucioneve të Kosovës. "Përmblyllja e këtij procesi do ta qartësojë përfundimisht funksionimin e administratës shtetërore dhe do ta kthejë atë në bazën themelore përgjatë rrugëtimit tonë drejt integritimit evropian. Para së gjithash, reforma e administratës publike është një prej shtyllave të Strategjisë së Zgjerimit të BE-së dhe një nga proceset kyçe për Agjendën Evropiane të Kosovës", ka thënë Tahiri.

Përveç prezantimit të arritjeve, në këtë takim ai ka shpalosur planin e veprimit dhe vizionin për procesin e reformës, më saktësisht gjashtë pikat kyçe të këtij procesi: (1) Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës, (2) Programin për Zvogëlimin e Barrës Administrative, (3) Projektligjin për Financat e Pushtetit Lokal, (4) Ligjin për Inspektimet, (5) Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, dhe (6) Strategjinë Kundër Korrupsionit.

OAK-u i prezanton kryetares së Kuvendit gjendjen e rëndë të biznesit

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 TETOR - Vështirësitë e bizneseve, si pasojë e pandemisë, përfshirja e kërkesave të bizneseve në Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, krijimi i Komisionit Parlamentar, i cili do të trajtojë çdo ligj dhe ta bëjë harmonizimin mes tyre në mënyrë që të njëjtat të mos bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, kërkesat e OAK-së për ndryshim/plotësimin e disa ligjeve specifike, përkrahja nga ana e shtetit dhe ulja e normës së interesit nga BQK-ja, ishin disa nga pikat kyçe të cilat përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) i kanë diskutuar gjatë takimit me kryetaren e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani.

Përgjatë këtij takimi përfaqësuesit e OAK-ut i kanë shprehur shqetësimin Osmanit për gjendjen e rëndë të të bërit biznes si rezultat i pandemisë Covid-19 dhe mosreagimit të Kuvendit në përputhje me këtë gjendje e cila

po rezulton me largim masiv të punëtorëve, falimentim të biznesit dhe ulje të madhe të buxhetit të shtetit. Si rezultat i kësaj, OAK-u, bazuar në vizitat e vazhdueshme që po i bën në terren dhe aktivitetet e saj, i shpalosi kërkesat e bizneseve duke kërkuar nga Osmani, ashtu siç është duke kërkuar nga çdo institucion tjetër shtetëror, që të trajtohen sa më shpejt këto kërkesa.

Përfaqësuesit e OAK-ut theksuan faktin se Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike nuk i zgjidh problemet e bizneseve. Për këtë arsye OAK-u ka dërguar edhe rekomandimet të cilat janë bërë në koordinim me sektorin e biznesit.

Përfaqësuesit e OAK-ut kanë bërë me dije se këto rekomandime i kanë dërguar disa herë me radhë në institucionet përkatëse si në qeveri ashtu edhe te deputetët, por që nuk janë marrë në konsideratë.

Anëtarë i bordit i OAK-ut, Hamdi Malushaj, ka potencuar faktin se



nuk mund të krijohen ligje për bizneset pa praninë e tyre.

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka falënderuar përfaqësuesit e OAK-ut për takimin dhe ngritjen e këtyre shqetësimeve dhe ishte e një mendimi, se secili ligj i cili bëhet duhet të jetë në pajtim me sektorin përkatës i cili do të afektohet nga ligji në fjalë.

Gëzim Selimi nga industria e mishit "Calabria" ka kërkuar mbështetje nga ana e shtetit për bizneset prodhuese. Ai ka theksuar se gjendja në terren nuk është aspak e mirë dhe se një numër i madh i qytetarëve tanë po mbesin pa punë.

Në kuadër të këtij takimi u diskutuan edhe problemet e pagimit të TVSh-së për lëndën e

parë kur ajo blihet brenda vendit dhe kërkimi i mëpastajmë për rimbursim, përderisa kur blihet jashtë vendit nuk paguan TVSh. Po ashtu, u trajtua edhe çështja e problemit për pushimin e lehonisë me ç'rast bizneset po detyrohen të paguajnë dy paga për një vend pune, ku një praktikë e tillë nuk është në asnjë vend të rajonit.

Osmani: Rimëkëmbja ekonomike e plotë, vetëm atëherë kur përkrahen prodhuesit



PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, e shoqëruar nga deputetet Donika Kadaj-Bujupi dhe Mimoza Kusari-Lila, priti të martën në takim përfaqësuesit e prodhuesve dhe ofruesve të shërbimeve vendore. Qëllimi i këtij takimi ishte që të diskutohet mbi sfidat me të cilat janë duke u ballafaquar bizneset si dhe të identifikohen mundësitë, instrumentet dhe politikat për t'i mbështetur ata në mënyrë të qëndrueshme.

Kryetarja Osmani ka thënë se

rimëkëmbja ekonomike është e plotë vetëm atëherë kur identifikohen instrumentet e duhura për t'i mbështetur prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve vendore. "Kur aktiviteti i tyre është stabil, po aq stabile është edhe ekonomia, ngaqë kjo përkthehet në vende të reja të punës, në vende të ruajtura të punës si dhe në zgjerim të aktivitetit biznesor që përfundimisht mund të rezultojë në eksport drejt vendeve të rajonit dhe të BE-së", ka thënë Osmani.

Nga ana e prodhuesve dhe ofruesve të shërbimeve vendore u përmend fakti se pandemia i ka dëmtuar rëndë bizneset e Kosovës me humbje financiare dhe në fuqi punëtorë. Ndaj ndihma ndaj bizneseve u tha se duhet të jetë e menjëhershme dhe prioritare në kuadër të pakos së rimëkëmbjes ekonomike. Ditët në vazhdim përfaqësuesit e prodhuesve dhe ofruesve të shërbimeve vendore do të takohen edhe me grupet parlamentare për t'i prezantuar kërkesat e tyre.

Gjatë pandemisë janë bërë 78 mijë kërkesa për shtyrje të këstit të kredisë

PRISHTINË, 13 TETOR - Kriza e pandemisë Covid-19 ka goditur edhe ekonominë e Kosovës. Për këtë arsye shumë persona dhe biznese janë detyruar të parashtrorjnë kërkesë në bankat e Kosovës për shtyrjen e pagesës së këstit të kredisë.

Zëdhënësi i Bankës Qendrore të Kosovës, Kushtrim Ahmeti, ka thënë se në periudhën mars, prill, maj dhe korrik janë parashtruar afër 78 mijë kërkesa për shtyrje të këstit të kredisë.

Ahmeti për "KosovaPress" ka thënë se nga 78 mijë kërkesa,

janë aprovuar 70 mijë e 564 kërkesa. "Nga 77 629 kërkesa të parashtruar për shtyrje të kësteve për periudhën mars-prill-maj-korrik, janë aprovuar 70 564 kërkesa nga të cilat 57 443 për personat fizikë dhe 20 186 për personat juridikë", ka bërë me dije Ahmeti.

Ndërsa në pyetjen, pas kësaj shtyrje të këstit të kredisë në tremujorin e parë, se sa ankesa janë pranuar për rritje të kamatës, Ahmeti ka thënë se janë 131 ankesa të cilat janë zgjedhur në favor të palëve. "Ju informoj se divizioni i ankesave në BQK deri më tani

ka pranuar 746 ankesa, nga të cilat 131 janë zgjidhur në favor të palëve, të tjerat janë kryesisht ankesa për interesin e rregullt të përllogaritur e që rezultojnë të jenë me përgjigje negative për palët", ka thënë ai. Banka Qendrore e Kosovës së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës kishin vendosur që bizneset dhe individët të cilët për shkak të gjendjes së krijuar në vend dhe rënies së nivelit të të hyrave të tyre, t'u mundësohet pezullimi i pagesave të kësteve të kredisë, nga data 16 mars 2020 deri më 30 prill 2020.



Fillon ndarja e 60-milionëshit për bizneset

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në Kosovë ka bërë me dije se ka ekzekutuar të martën pagesën e parë për përkrahje financiare për bizneset e vendit. Sipas një komunikate për media të kësaj ministrie, nga 60 milionë euro që ishin ndarë nga Qeveria e Kosovës për t'i ndihmuar bizneset, janë ekzekutuar mbi 37 milionë euro për rreth 16 mijë biznese të cilat i kanë plotësuar kushtet në këtë fazë. "Në kuadër të zbatimit të planit, i aprovuar sot nga Qeveria e Republikës së Kosovës për

zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) ka ekzekutuar sot pagesën e parë në kohë rekorde për përkrahje financiare për bizneset e vendit. Vendimi i qeverisë për mbështetje ndaj bizneseve ka ardhur si rezultat i kërkesës së vazhdueshme nga ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi. Shuma e cila është ndarë në këtë kategori arrin vlerën e 60 milionë euro subvencione ku gjatë ditës së sotme nga MEA është ekzekutuar pagesa e parë prej



37,710,730 milionë eurosh për 15 745 biznese të cilat i kanë plotësuar kushtet në këtë fazë

sipas programit për rimëkëmbje ekonomike", është bërë me dije në njoftimin e kësaj

ministrie, ku është theksuar se pjesa tjetër e vendimit do të zbatohet në ditët në vijim ku do të përfitojnë të gjitha bizneset të cilat kanë aplikuar sipas kriterëve të parapara.

Qeveria e Kosovës më 28 shtator ka ndarë 60 milionë euro për bizneset private, për t'i rikuperuar humbjet që kanë pësuar nga pandemia Covid-19. Bizneset është thënë se do të ndihmohen në bazë të listës së numrit të punëtorëve të regjistruar që kanë në muajin dhjetor të vitit 2019, ndërkaq për bizneset e reja merren të dhënat e muajit korrik të vitit 2020.

Përfaqësuesit e Këshillit të Investitorëve Evropianë premtojnë përkrahje për sektorin e ekonomisë

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të martën përfaqësuesit e Këshillit të Investitorëve Evropianë në Kosovë, me të cilët ka diskutuar për angazhimin e qeverisë drejt rimëkëmbjes ekonomike si dhe për krijimin e një ambienti sa më të mirë të të bërit biznes. "Situata e krijuar nga pandemia Covid-19 na obligon që të veprojme në sinergji me të gjithë aktorët, në mënyrë që të jemi sa më afër nevojave të qytetarëve dhe bizneseve. Ne tashmë i kemi dyfishuar subvencionet në bujqësi, po ashtu i kemi aktive mjetet financiare në vlerë prej 60 milionë eurosh që do t'i

ndihmojmë bizneset, mirëpo nuk i kemi lënë pa përfshirë edhe kategoritë e tjera në nevojë dhe komunitetet", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Më tej, kryeministri Hoti dhe të pranishmit biseduan për dialogun e institucioneve të Kosovës me sektorin privat, Ligjin për Investime Strategjike, si dhe Fondin për Garantim të Kredive, të gjitha këto në funksion të zhvillimit ekonomik dhe tërheqjes së investitorëve. Ndërsa përfaqësuesit e EIC-së, duke e vlerësuar kryeministrin Hoti për pritjen, u zotuan se mbeten partnerë seriozë në proceset e zhvillimit ekonomik si dhe garantuan thellim të bashkëpunimit të mëtejshëm.



Shqyrtohet Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin 2019



PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar të martën Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin 2019.

Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka thënë se i kanë pranuar gjetjet dhe se janë duke punuar për zbatimin e tyre. "Ky raport ka të bëjë vetëm me një pjesë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit. Gjetjet janë në numër të caktuar, ato që janë përsëritur dhe ato që kanë ndodhur për herë të parë. Për

mua ka të bëjë me disa gjetje që, për fat të keq, mund të përsëriten prapë, të cilat janë edhe jashtë kompetencave tona", ka thënë ministri Kuçi.

Ai ka bërë me dije se për këto çështje janë duke biseduar me zyrën e kryeministrit kurse, sipas tij, gjetjet e tjera janë të zbatueshme. "Jemi duke përcjellë procesin e implementimeve të gjetjeve që janë bërë në bazë të raportit. Ne këto gjetje i kemi pranuar si të tilla dhe kemi hartuar një plan për t'i zbatuar të gjitha gjetjet", ka deklaruar ministri Kuçi.

'Jetimat e Ballkanit' do të ndërtojnë 15 shtëpi në Komunën e Pejës

PEJË, 13 TETOR (ER) - Drejtuesi i shoqatës humanitare "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, ka treguar se do të ndërtohen edhe 15 shtëpi të reja në Komunën e Pejës. Kastrati përmes një statusi në rrjetin social në "Facebook" ka shkruar se është arritur një memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ku për secilën shtëpi komuna do të participojë nga pesë mijë euro. Sipas tij, pjesën tjetër të shpenzimeve do të participojnë donatorët e tjerë.

"Memorandum bashkëpunimi. Edhe 15 shtëpi të reja po ndërtohen në Komunën e Pejës. Sot nënshkruam memorandum bashkëpunimi me Komunën e Pejës për ndërtimin e 15 shtëpive për familjet nevojtare. Bashkë me kryetarin Gazmend Muhaxheri bëmë nënshkrimin e këtij memorandum ku për secilën shtëpi komuna do të participojë me pesë mijë euro, ndërsa pjesën tjetër donatorët përmes shoqatës sonë. Bamirës, kurrë Zoti mos ju humbtë!", ka shkruar Kastrati.



Asambleja Komunale e Fëmijëve në Mitrovicë filloi procesin për zgjedhjen e strukturave të reja

MITROVICË, 13 TETOR (ER) - Asambleja e Fëmijëve në Komunën e Mitrovicës të martën ka mbajtur takimin e radhës ku është diskutuar për zgjedhjen e strukturave të reja të asamblesë. Për ta përshëndetur punën e asamblesë së fëmijëve i pranishëm ishte nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, Fitimi Rama, udhëheqës i Njesisë për të Drejtat e Njeriut, përfaqësues të OJQ "Syri i Vizionit".

Asambleja komunale është funksionale falë mbështetjes së dhënë nga Njësia për të Drejtat e Njeriut, OJQ "Syri i Vizionit" nga Peja dhe e mbështetur nga organizata "Save the Children".

Në fjalën e tij, nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, ka përshëndetur të gjithë fëmijët asamblistë të cilët në të ardhmen do të jenë asamblistë të vërtetë të komunës e do të bëhen zëri i shpësës dhe i ndryshimeve të mëdha në vend. "Tek ju fëmijë të dashur shoh shumë vullnet e energji për ndryshime të



mëdha në shoqërinë tonë, e padyshim që ju do të jeni asamblistët e ardhshëm të qytetit. Që nga mosha e juaj është mirë të krijoni një kulturë të barazisë, një frymë të re në shoqërinë tonë ku kemi të drejta të barabarta për të gjithë fëmijët dhe pjesëmarrjen e vajzave në procese të ndryshme. Ju do të jeni zëri i shokëve nga shkolla, nga lagjja dhe besoj se do t'i shtroni për diskutim të gjitha problemet dhe sfidat që ju shqetësojnë. Ndërkaq, ne do të bëjmë çmos që këto probleme t'i zgjidhim dhe që asambleja juaj të funksionojë pa probleme", ka thënë Mujka.

Ndërsa udhëheqësi i Njesisë për të Drejtat e Njeriut, Fitim Rama, u tha nxënësve asamblistë se ata, për t'i realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e asamblistit, duhet të angazhohen shumë, të bashkëpunojnë dhe të këmbëjnë përvoja. Gjithashtu, gjatë këtij takimi koordinatori i njesisë për të drejtat e njeriut në Komunën e Mitrovicës ka shprehur gatishmërinë për mbështetje të vazhdueshme për asamblistët e fëmijëve në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta, sidomos për respektimin e të drejtave të tyre dhe pozitës së tyre në shoqëri.

Parkingu nëntokësor tek UP-ja do të përfundojë pas zgjedhjeve komunale

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka prezantuar të martën në një konferencë për media projektin e parkingut nëntokësor tek Universiteti i Prishtinës, për të cilin ai ka thënë se po ofrojnë një zgjidhje për qendrën e qytetit. Ai ka thënë se parkingu nëntokësor do të përfundojë pas zgjedhjeve komunale. "Këtë projekt nuk po e bëjmë për fushatë, por po ia lëmë Prishtinës si diçka të bukur. Projekti nuk ka qenë ide e jona, por ka ekzistuar kaherë", ka deklaruar Ahmeti derisa ka

thënë se punimet janë vonuar për shkak se kishte kërkuar që drunjtë që ndodhen aty të ruhen. "Nuk premtoj se të gjithë drunjtë do të ruhen, por po bëjmë përpjekje që shumica prej tyre të zhvendosen e pas përfundimit të projektit të kthehen sërish", ka thënë Ahmeti. Kryetari i Prishtinës ka bërë me dije se tashmë gradualisht do të fillojnë që disa rrugë të qendrës t'i mbyllin. Parkingu nëntokësor do të ketë 23 mijë metra katrorë hapësirë parkingu, dy kate nga 11 500 metra katrorë, përafërsisht 700 vende të parkingut.



KEDS-i i kundërvihet erës me linjë tërësisht të re në fshatrat e Istogut

ISTOG, 13 TETOR (ER) - Pikërisht mbi Dubravë të Istogut, rrugës për Mojtir dhe Shushicë, tashmë kanë zënë shtat dhjetëra shtylla betoni të tensionit të mesëm. Punëtorët e KEDS-it po punonin me intensitet për shtuar në fillim të tetorit për ndërtimin e linjës së re që do t'i furnizojë me energji mojtirasit e shushicasit. Rrjeti i ri është integruar me bukurinë e këtyre fshatrave

piktorese që gjelojnë nga gjelbërimi edhe këtë fillim vjeshte. Qindra banorë të asaj pjese, të rrahur nga erërat më të fuqishme në Kosovë, do të kenë shërbime dukshëm më kualitative. Kjo linjë e cila është e gjatë tri kilometra ka të instaluar 51 shtylla betoni me të gjitha stabilimentet e tjera përcjellëse, tërësisht të reja. Me ndërtimin e saj, përpos që

është rritur siguria në furnizim kualitativ me energji, janë eliminuar edhe mbingarkesat në rrjet, të cilat në të kaluarën rrezikonin furnizimin. KEDS-i vazhdon që me përkushtim dhe profesionalizëm të investojë gjithandë vendit në projekte madhore për t'i rehabilituar linjat ekzistuese dhe duke krijuar alternativa të reja të furnizimit për të gjithë konsumatorët.



JO PARAMILITARË DHE JO MASAKRA



Nga Jakup KRASNIQI

Në mediat tona shpesh po na bie të dëgjojmë terma të gabuar, terma që nuk e shpjegojnë atë që e synojmë ose e dëshirojmë dhe më se paku e mbulojnë atë që ka ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998/99. P. sh., më 12 tetor në mediat tona lexova se në Sllovi të Lipjanit “dëshmitarët kanë deklaruar se në vitin 1999, bashkëfshatarët serbë në fshatin Sllovi, të veshur me uniforma paramilitare, kanë vrarë rreth 45 persona dhe kanë djegur shtëpi”. Madje shpeshherë të tjera flasim për masakra si, p. sh., Masakra e Reçakut etj. Dëshmitarët edhe mund të thonë atë që e kanë thënë, por interpretimi i tyre në mediat tona duhet të bëhet ashtu siç ka qenë dhe siç duhet. Tani edhe mos të habitemi, kur në librat e hartuar nga “akademikët” të hasim terma siç ishte ai për krimin e gjenocidit të kryer në Reçak më 15 janar 1999, “incident”?! Për nivelet e tilla intelektuale, nuk duhet të habitemi edhe nëse të gjitha luftërat, nga ajo e Shqipërisë së Toplicës të quheshin incidente. Është koha e fundit, që të gjitha

luftërat e Serbisë nga ajo e vitit 1876/78 e deri te lufta e fundit 1998/99, që kishin për qëllim zhdukjen e tërësisht apo të një pjese të shqiptarëve nga trojet stërgjyshore.

Vrasjet në Sllovi e kudo në Kosovë në të gjitha kohët dhe në luftën e fundit i kanë bërë qeveritë e Serbisë dhe kryekreje policia dhe ushtria serbe. Pa politikën e programuar të qeverive serbe nga “Naçertanija” e deri te Memorandumi i ASHAS-së dhe Plani “Patkoi”, asnjë formacion banditesh kurrë nuk do të mund të ushtronte politika të krimit e të gjenocidit, pa qenë pjesë e pandarë e policisë dhe e ushtrisë serbe. Fajësimi i paramilitarëve me vrasjet e masakrat do të thotë, ç’fajësim i shtetit të Serbisë nga politikën e krimit e të gjenocidit të kryera mbi shqiptarët për gati dy shekuj.

Konventa e OKB-së e vitit 1948 e miratuar më 12 janar 1951 ka përcaktuar se çka është gjenocidi. Konventa, Neni II i saj, i ka pesë pika dhe secila prej tyre që është kryer me qëllim të zhdukjes plotësisht a pjesërisht ndaj një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar, është vepër e gjenocidit. Për këtë më mirë po ia lemë që të flasë vetë Neni II i Konventës për Gjenocidin, i cili thotë:

“Neni II: Konventa përcakton veprimet të cilat përbëjnë krimin e gjenocidit. Sipas saj, (neni 2) gjenocid konsiderohet çilido nga

veprimet e mëposhtme, i kryer me qëllim që të zhduket plotësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar. Këtu bën pjesë: (a) vrasja e anëtarëve të grupit;

(b) lëndimi i rëndë fizik ose mental i anëtarëve të grupit;

(c) vënia e grupit qëllimisht në aso kushte të jetës që duhet të sjellin zhdukjen e plotë fizike ose të pjesësme të tij;

(d) ndërmarrja e masave drejtuar në pengimin e lindjeve brenda grupit; dhe

(e) transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga një grup në tjetrin”.

Të gjitha këto forma të krimit shteti i Serbisë që nga lindja e tij e krejt deri në vitin 1998/99 i ka kryer në Kosovë, Maqedoni perëndimore, në Shqipërinë e Toplicës, në Mal të Zi e Sanxhak e deri në Shqipëri, me qëllim që mos të linte farë shqiptarë e as shtet shqiptar. Këtë na e konfirmojnë shumë plane e programe të Serbisë ndër vite.

Prandaj mediat tona, politika jonë e sidomos akademikët tanë duhet të jenë të kujdesshëm si në të folur ashtu dhe në të shkruar për këto çështje. Deri tash kemi qenë shpesh të pakujdesshëm. Koha është që ta ndryshojmë qasjen tonë. Madje dikush edhe duhet të japë përgjegjësi për gabimet e bëra. Politikanët dhe akademikët tanë nuk mund t’i shpëtojnë përgjegjësisë politike, kombëtare, morale e profesionale. Këta të fundit duhet të kenë moral të lartë për



Komuna e Ferizajt dhe KFOR-i italian shkëmbejnë përvoja në menaxhimin e Covid-19

FERIZAJ, 13 TETOR (ER) - Në ambientet e zyrës së kryetarit të komunës, i pari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Bekim Ademi, drejtoreshën e QKMF-së, Nadire Imeri, drejtorin e Spitalit të Përgjithshëm, Jeton Zeqiri, drejtorin e Komandës Rajonale të Policisë së Kosovës - rajoni i Ferizajt, Emin Beqiri dhe drejtoreshën e QRShP-së, Sevdije Mehmeti, pritën në takim një ekip mjekësh dhe infermierësh në kuadër të KFOR-it italian. Temë e diskutimit ishte gjendja e përgjithshme dhe menaxhimi i pandemisë Covid-19 në nivelin lokal. Kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, bëri një bilanc të të gjitha veprimeve që ka ndërmarrë

Shtabi Emergjent për përmbyshje të masave mbrojtëse kundër virusit Covid-19. Ai shtoi se aktualisht Ferizajt është i qetë, numri i të infektuarve është i vogël, kurse po rritet numri i të shëruarve. Mysafirët shprehën vullnetin që të ndihmohet komuna në formën e ndryshme, bazuar edhe në përvojat që pati shteti italian gjatë përballjes me pandeminë. Nga drejtuesit e institucioneve shëndetësore në nivelin lokal u parashtruan kërkesat dhe përvoja lidhur me menaxhimin e gjendjes, për të cilën me bashkëpunime të tilla si ky me KFOR-in italian, Komuna e Ferizajt pret ballafaqim më të lehtë të kësaj situatë.



RAMOSAJ DO TË JETË KANDIDAT I AAK-së PËR KRYETAR TË DEÇANIT EDHE PËR NJË MANDAT

DEÇAN, 13 TETOR (ER) - Bashkim Ramosaj ka marrë besimin e liderit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, edhe për një mandat si kandidat i kësaj partie për kryetar të Komunës së Deçanit në zgjedhjet e ardhshme lokale. “Në takimin e mbajtur dje kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj, më ka besuar duke

më nominuar edhe për një mandat kandidat për kryetar të Komunës së Deçanit. Dëshiroj së pari ta shpreh mirënjohjen për kryetarin e AAK-së, z. Ramush Haradinaj, strukturat e AAK-së në Deçan si dhe të gjithë qytetarët e Deçanit për mbështetjen e vazhdueshme. Do t’ia dalim bashkë”, ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në “Facebook”.



Aristidh Kola dhe identiteti kulturor arvanitas



Nacionalizmi kulturor në marrëdhëniet greko-shqiptare dhe anasjelltas shfaqet dhe rishfaqet dhe në ndikimet që ka pasur kuadër të ringjalljes së nacionalizmit në vitet 90-të në rajon, interesimi për të shkuarën e largët të vendit të origjinës dhe një confirmim i një afërsie etnike me shqiptarët nga popullsia shqipfolëse të njohur si arvanitase në Greqi.

Sigurisht influenca e nacionalizmit etnik grek dhe një tradite bashkëjetese prej më se 170 vjetësh në shtetin kombëtar grek ku elementi arvanitas kish hyrë në një proces asimilimi nuk mund të bëjë të mundur që këto demonstrime të jenë të një përmase të madhe, por gjithsesi nuk duhen konsideruar të papërfillshme pasi kanë ringjallur një çështje të harruar dhe që nën tendencat unifikuese të Globalizmit kishte tendenca për tu harruar. Një nga veprimtarët më të rëndësishëm të ringjalljes kulturore arvanitase gjatë viteve 1980-2000 është studiuesi, avokati dhe publicisti Aristidh Kola i cili në librin e vet "Arvanitët dhe prejardhja e grekëve" i bëri jehonë sërish mitit pellazg të origjinës së përbashkët greko-shqiptare që nga lashtësia dhe ripohon me krenari se 90 nga 100 heronj të

Kryengritjes janë arbër, por kjo jo vetëm që nuk përmendet nga historianët tanë, por bëhet përpjekje të fshihet ky fakt dhe nga ana tjetër të përdëllehet i gjithë populli arbëror. Nën procesin e vazhdueshëm të helenizmit të nxitur dhe nga shteti kombëtar grek, përpjekja e arvanitasve për të shkruar dialektin e tyre shqip u minimalizua deri sa në vitet 80-të të shekullit të XX kemi një rigjallërim të këtyre përpjekjeve me botimin e revistës "Besa", ku në të 34 numrat e saj përveçse artikujve shkencorë rreth kulturës arvanitase në greqisht u botuan dhe artikuj në gjuhën shqip por me alfabetin grek. Që prej viteve 1980-te, ka pasur një krijim të shoqërive kulturore arvanitase edhe botimeve të një reviste edhe disa librave mbi kulturën arvanitase (megjithëse shume pak të botuara në atë gjuhë). Në disa zona, Ungjilli i Pashkëve lexohet në Arvanitika

(Gerou, 1994a). Ndoshta ndërmarra me domethënëse – për publikun e gjere – është nxjerrja e CD – me një libërshkë të bashkangjitur shpjegimi – Arvanitic Songs (FM Records, 1994). Në këto kushte ka qenë shumë e vështirë influencimi i një nacionalizmi kulturor me tendenca shqiptare nga ana tyre pasi nuk zhvillimet politike në Shqipëri kanë qenë më të vonshme sesa në Greqi. Madje në rastin e tyre mund të flitet për ringjalljen e një teze të hershme dhe romantike të nacionalizmit etnik shqiptar që i kërkonte rrënjët e veta në origjinën e përbashkët pellazgjike me popullsinë greke. Një sërë librash të shkruar nga elita e këtij komuniteti vital në Greqi si "Arvanitët dhe prejardhja e grekëve" e Aristidh Kolisë apo "Arvanitasit-fiset e reja doriane të Helenizmit të ri" të Kosta Birit e shtjellojnë më

tepër këtë tezë, duke e bërë dominante në ligjërimin e sotëm arvanit. Mirëpo, brenda këtij ligjërimi historik e kulturor shpesh herë shtjellohet dhe nuanca krenarie për numrin e madh të udhëheqësve të Revolucionit Grek nga gjiri i kësaj popullsie, afërsia dhe ndihmesa e shqiptarëve në këtë Revolucion si dhe përforcimi i disa karakteristikave të veçanta të popullsisë arvanitase si trimëria, besa e sakrificat për atdheun. Të gjitha këto tipare identitare kanë krijuar premisat për të pasur herë pas here shfaqje të një nacionalizmi të zbehtë kulturor që u vu re nga përfaqësues të shquar të këtij komuniteti si Aristidh Kola, Taqi Mihas etj gjatë ndërhyrjes së NATO-s në Ish-Jugosllavi ku në emisione të ndryshme televizive dhe artikuj në gazetat më të mëdha greke mbrojtën çështjen shqiptare përkundrejt mendimit nationalist grek që e denigronte, argumentuan se përse Greqia nuk duhet të ishte aleate me Serbinë, aleancë për të cilën qarqet nacionaliste greke bërtisnin se është e "shenjtë" si dhe pohuan afërsinë e tyre etnike shqiptare. Zhvillimi i këtij nacionalizmi të zbehtë kulturor që ngjalli dhe acarim në qarqet nacionaliste

greke, i përngjan tipit të zhvillimit të nacionalizmit që përqafohet nga një grup intelektualësh që tregojnë interes për gjuhën e popullit dhe folklorin duke pohuar veçantinë dhe afërsinë me një komb tjetër fqinj, gjë që krijon premisa që dalë nga dalë në të ardhmen dhe nën dritën e zhvillimeve të ndryshme politike në Ballkan mund të kalojë në hapa të tjerë më të rëndësishëm të identifikimit të popullsisë në rajon.

Modeli i Renanit i përzgjedhur nga elita greke për të formuar kombin grek shekullin e kaluar mund të shërbejë dhe anasjelltas ku grupe identitare mund të rigjejnë rrënjët e humbura. Vepra e studiuesit Aristidh Kola është një thesar i paçmuar për plotësimin e Atlasit Gjuhësor të shqipes që për fat të keq deri tani pasqyron vetëm të folurat arvanite të studiura në vitet 30' nga dietari dhe gjuhëtari tjetër i shquar arvanit Petro Furiqi. Për më tepër ajo është një grishje intelektuale rreth komb-formimit dhe modeleve kulturore të harruara por gjithmonë ndjellëse për paqen në rajon ndaj duhet të zërë një vend të veçantë në kulturologjinë shqiptare/ Dorian Koçi, Koha Jonë. /Kultplus/

Esé

Vendi i shqiponjave

Nga: Mario Vargas Llosa
(El País, 1997)

Për Shqipërinë, vend ku nuk kam shkelur ndonjëherë por që e njoh nga romanet e mira të Ismail Kadarese, kam pasur një nga diskutimet më të nxehta që mbaj mend. Kundërshtari im ishte një djallushkë femër, në dukje, që quhej Uma Thurman, suedeze me origjinë dhe artiste me profesion, me një siluetë si shufër dhe me flokë të rimitë, me të cilën, për kënaqësi të syve të mi dhe tmerr të shijeve e bindjeve të mia, para dy vjetësh u bëmë bashkë në jurinë e Festivalit të Kinemasë të Venecias. Duke përdorur mjetet e pafundme bindëse (inteligjencën, qarjen, joshjen, shantazhin, frikën, lutjen) dhe një aftësi për intrigë të denjë, si ajo e Makiavelit dhe Rastinjakut bashkë, ajo ia arriti që t'i jepte çmimin special të konkursit, filmit të tmerrshëm "Natural Born Killers" (Vrasës të lindur) të demagogut Oliver Stone, dhe të futë në listën e fitimtarëve filmin "L'America" të italianit Amelio, film që e tregon Shqipërinë si një vend makthesh, i populluar nga turma njerëzish të pazhvilluar që lypin ose vjedhin, grumbuj njerëzish-larva të shushatur nga uria dhe kotësia. Jam i sigurt se ata që nuk e njohin Shqipërinë, si dhe unë, dhe që shohin këtë film, kanë për të besuar se është një film profetik, sepse në një vend të ngjashëm dhe me njerëz të tillë, tmerrret që po ndodhin këto ditë, në një farë mënyre duhet të ndodhin, shpejt apo vonë. Si ato që ndodhën në Ruandë, Burundi apo Haiti.

Megjithatë, e vërteta është se shpërbërja e përgjithësuar dhe kaosi shoqëror e politik që ka pushtuar Shqipërinë, për të merituar ato keqardhje të këndshme ose befasi të frikshme që dëgjojmë dhe lexojmë përditë në mediat e vendeve të civilizuar, në vend të flitet për tragjedinë shqiptare sikur të flasësh nga hëna, do të ishte mirë ta na e ilustronin për shkak të mosnjohjes tonë, dhe të na hapnin sytë në lidhje me filmin tepër të dobët, mbi të cilin mbështetet moderniteti, progresi, kultura demokratike në shoqëritë e zhvilluara. Ashtu si edhe në ish-Jugosllavi, kriza e Shqipërisë tregon se, ndërkohë që hyrja në civilizim është e gjatë dhe e vështirë, rënia në barbari është mjaft e lehtë, një rezik kundër të cilit nuk ka ilaç përfundimtar.

Një nga shpjegimet më absurde mbi shkërkimin e rendit në Shqipëri, është se fajin e paska "kapitalizmi", apo, siç preferon gjuha e pakuptueshme e mirëmenduar, "ultra-

liberalizmi" që ish-kardiologu dhe i përkrahuri i Enver Hoxhës, presidenti Sali Berisha, u përpoq ta fusë me forcë për të kënaqur zotërit e tij perëndimorë (kryesisht Shtetet e Bashkuara, të cilët e trajtuan me shumë mirëdashje në krahasim me rivalët e tij politikë, qëkur u shpall antikomunist). E vërteta është krejt ndryshe. Gjysmë shekulli despotizëm stalinist që vuajti shoqëria shqiptare, e sterilizoi në atë mënyrë jetën shoqërore dhe ekonomike – aty funksionoi vetëm jeta e dhunshme dhe policore – sa asnjë institucion nuk mund të hidhte dot rrënjët paskëtaj, kur diktatura u shemb. Ajo u shemb por, atje lart, nuk u zhduk: si unazat e gjarprit që i pret kokën,

vazhdoi të godasë me metodat e zakonit e saj dhe një numër i mirë korifenjsh e përfituesish, me një makijazh të lehtë reformist, ruajtën pushtetin e tyre edhe në demokracinë e brishtë që erdhi për ta zëvendësuar atë diktaturë. Shembull më i mirë i tyre është vetë Sali Berisha, të cilin regjimi e birësoi deri në ekstrem duke e lejuar të udhëtojë e të studiojë jashtë shtetit (privilegj i paimagjinueshëm për një shqiptar të zakonshëm) dhe që pastaj u bë drejtues në Partinë e Punës dhe mjek kryesor i Enver Hoxhës, Komandantit. Kur mbërriti ora e ndryshimit, u vetëshpall demokrat, konservator dhe "atlantist", dhe, për ta provuar këtë, sapo fitoi zgjedhjet e 1992-shit, futi në burg vejtashën e Hoxhës, zëvendësin e tij, Ramiz Alinë, dhe një grusht funksionarësh të regjimit të përmbysur. Qeveritë perëndimore pranuan deklaratat e tij se demokratizimi i Shqipërisë ishte vënë në vijë.

Në të vërtetë, bëhej fjalë për një farsë të pastër. Njësoj si në Rusi dhe për të njëjtat arsye, dobësia apo pazotësia absolute e institucioneve civile – veçanërisht ajo e drejtësisë dhe e gjykatave – u la fushë të lirë veprimi perandorisë së mafiozëve, bandave të kriminelëve të kryesuar nga ish-sigurimsat dhe burokratët e regjimit komunist, të cilët morën në dorë administrimin e ndërmarrjeve (ose më mirë për t'i asgjësuar ato), për t'i shitur apo privatizuar, madje ata u pajisën me pasaporta dhe viza për të qarkulluar mall lirshëm. Po bën, pak a shumë, një vit që pati një dokumentar të mrekullueshëm mbi këtë temë nga BBC, i cili me dëshmitarë interesantë tregonte se si industria e narkotrafikut kishte krijuar filialet e veta në Shqipëri me siguri të plotë mosdënimi. Dhuna e ashpër u bë e vetmja formë e ligjshme, dhe



korupsioni u shtri në të gjitha nivelet e shoqërisë, si skena kryesore e mbijetesës.

Në këto kushte në Amerikën Latine, Ushtria nxjerr tanket në rrugë dhe merr pushtetin. Por, në vende si Shqipëria (ose Rusia, për rastin), anoreksia ekonomike që rezultoi për disa dekada centralizmi, estatzimi dhe planifikimi, është aq e thellë sa edhe institucionet e privilegjuara, si Forcat e Armatosura, nuk ngrihen dot në këmbë nga rraskapitja dhe rrënimi i plotë ku janë katandisur, madje nuk kanë më as shpirtin dhe as refleksat e domosdoshme për të bërë një grusht shteti. Lehtësia me të cilën turma e dalldisur sulmoi kazernat dhe komisariatet në Tiranë, Durrës, Shkodër e vende të tjera dhe rrëmbeu të paktën 300 000 pushkë, është tepër kuptimplote për moralin që sundonte në shtresën ushtarake. Prandaj, është e mundur të pohohet se, në disa qendra, vetë oficerët e nxitën bastisjen, për të fshehur trafikun me armë dhe municione, i cili kishte kohë që ishte bërë burim kryesor jetese për ushtarakët.


Në këtë kontekst varfërie ekonomike, pavendosmërie politike, zbrastëie institucionale dhe pasigurie kolektive, rezultoi shumë e lehtë që njeriu të besojë në mrekullinë, siç ishin "firmat piramidale". Është interesante se ky lloj mashtrimi përsëritet herë pas here në vendet e varfra ose në kohë krizash dhe, megjithatë, jo vetëm që askush nuk vë mend, por mijëra apo miliona të pafajshëm bien përsëri në kurth. Kjo është vërtet absurde, deri qesharake. Një bankë ose një financier ofron interesa tepër të larta dhe me një afat të shkurtër për kursimet e klientëve të vet, dhe investitorët e parë, në fakt, vazhdojnë të përfitojnë, sajim që qëndron në këmbë vetëm po të vazhdojnë depozitimet e klientëve të rinj. Në momentin që numri i tyre bie apo rritet

alarmi dhe fillon tërheqja e klientëve, atëherë skema shembet: mashtruesit zhduken dhe viktimat ngelen me gisht në gojë. Ky lloj mashtrimi është shumë i hershëm, por, me sa duket, e reja në këtë rast është se një vend i tërë pati aq shpresa sa e la veten të mashtrohet me një mendjehetësi të padëgjuar më, duke bërë që të pasurohen mashtruesit me kursimet e tyre të varfra pa kurrfarë mundimi. Por, nuk duhet kështu, dhe as nuk është mirë të jetë kështu. Në qoftë se pasuria bie nga qielli dhe nuk vjen si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme, krijon zakone të liga dhe nuk të përgatit për të përballuar vështirësitë dhe fatkeqësitë. Kështu, për shembull, ari i zi që ka mbytur nëntokën e Venezuelës, i ka sjellë asaj më shumë fatkeqësi se sa mirëqenie. Mirëqenia që vjen nga aftësia dhe përpjekja është një mijë herë më e mirë nga mirëqenia që vjen aksidentalisht – nga lotaria apo mrekullia – sepse vetëm e para ka mundësi të zgjasë dhe të shtohet, siç e kërkojnë rrethanat.

Ndoshta duhet thënë e njëjta gjë edhe për demokracinë, këtë sistem që, me gjithë defektet e veta, është sistemi që na mbron më mirë kundër brutalitetit dhe që u reziston më shumë kohë tentativave të herëpashërme të kthimit të barbarisë prej të cilave ankohen të gjithë kombet. Ajo që ndodhi në Rusi në ditët tona dhe në një pjesë të madhe të ish-perandorisë sovjetike, katastrofa mizore ku është zhytur Shqipëria, peripecitë e tmerrshme që kanë pllakosur vendet e Amerikës Latine në përpjekjet për të arritur progresin dhe modernizimin e vërtetë, po ashtu gjakrrjedhja dhe zia e madhe që vuajnë sa e sa kombe afrikane, nuk tregojnë se ka popuj të aftë dhe popuj jo të aftë për të qenë të lirë dhe të begatë. Por, tregon se liria dhe prosperiteti nuk vijnë nga

mbrëmja në mëngjes. Ato fitohen dhe meritohen, pak nga pak, përmes disa praktikave, gjatë adaptimit të disa ideve dhe praktikave, me anën e të cilave bën të funksionojnë institucionet (dhe jo e kundërta). Diktaturat gjithmonë dobësojnë dhe dëmtojnë këtë proces: të gjitha diktaturat, por, më shumë se askush tjetër, diktaturat si ajo që vuajti Shqipëria – ose që po vuan tani Koreja e Veriut apo Kuba dhe Kina; diktatura që kanë marrë përsipër gjithë përgjegjësinë e jetës së qytetarëve të tyre, duke i kthyer këta në automatë të thjeshtë, veprimet e të cilëve, të rëndësishme apo të parëndësishme, të vendosen nga vetë pushteti gjithëpërfshirës, i cili i edukon, i ushqen, i ndihmon, i informon dhe u jep punë. A do të jenë në gjendje të vepronë me përgjegjësinë e tyre këta qytetarë të cilët gjatë brezash kanë qenë të kushtëzuar e të komanduar për të qenë të bindur, për të qenë thjesht instrumente? A do t'i respektojnë institucionet këta njerëz, të cilët lindën dhe vdiqën midis institucioneve që kurrë nuk e merituan respektin e tyre si qytetarë? Si mundet që këta, nga mbrëmja në mëngjes, do të bëhen qytetarë që duhet t'u besojnë ligjeve dhe të jenë të përgjegjshëm për lirinë e tyre, liri që ishin mësuar ta shikonin si një perde të thjeshtë tymi pas së cilës fshihej arbitrariteti, liri që ishte vetëm një fjalë boshe dhe që shërbente vetëm për të ndritur fjalimet e diktatorëve? Tragjedia e Shqipërisë, këtij "vendi të lashtë të shqiponjave", nuk filloi me mashtrimin e firmave piramidale. Ajo që shohim tani nuk është veçse plasja e qelbit të një lunge të krijuar gjatë dekadave të despotizmit dhe shtypjes së egër.

El País, 1997 Përktheu nga originali Bajram Karaballi (Marrë nga ExLibris)



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Berisha, Zeneli dhe Zhegrova mungojnë në ndeshjen ndaj Greqisë

Kombëtarja e Kosovës sot (e mërkurë) në Athinë do të luajë kundër Greqisë në kuadër të Ligës C të Ligës së Kombeve. Në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës bëhet me dije se Bernard Challandes nuk do t'i ketë në dispozicion edhe Valon Berishën, Arbër Zenelin dhe Edon Zhegrovën



PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Kombëtarja e Kosovës është nisur të martën për në Athinë, ku sot (e mërkurë) do të luajë kundër Greqisë në kuadër të Ligës C të Ligës së Kombeve. Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar edhe për mungesat

që do t'i ketë Kosova në përballjen me Greqinë. "Me ekspeditën e 'dardanëve' nuk udhëtuan Valon Berisha, Arbër Zeneli dhe Edon Zhegrova, për të cilët, pas ekzaminimeve mjekësore në mëngjes, u konstatua se nuk janë në

gjendje të luajnë në ndeshjen kundër Greqisë", është thënë në njoftimin e FFK-së.

Kombëtarja e Kosovës të martën në mbrëmje ka mbajtur

stërvitjet në Athinë.

Kosova është pjesë e Grupit 3 në Ligën C të Ligës së Kombeve, ku ka marrë vetëm një barazim nga tri ndeshje të zhvilluara.

Greqia është lidere e grupit me shtatë pikë, nga dy fitore dhe një barazim, ndërsa kujtojmë se kishte fituar ndaj 'dardanëve' në "Fadil Vokrri".

Ministrja Dumoshi nderohet nga Federata Bjeshkatore Alpiniste e Kosovës

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur të martën në takim drejtuesit e Federatës së Bjeshkatarëve Alpiniste të Kosovës. Në këtë takim ishin të pranishëm kryetari i Federatës, Arben Lila, nënkryetari dhe njëkohësisht shqipëruësja e librit, Teuta Bicaj, si dhe alpinisti dhe shqipëruesi i librit Abdurahim Abdushi.

Gjatë këtij takimi ministres Dumoshi iu dhurua libri "Aftësitë bjeshkatore: Shkolla Verore", i shqipëruar nga prof. Teuta Bicaj dhe Abdurahim Abdushi, si shenjë mirënjohje për përkrahjen e vazhdueshme



që i jep sportit. Libri në fjalë është vepër e krijuar nga Federata Ndërkombëtare e Bjeshkatarisë dhe Alpinizmit (UIAA) në bashkëpunim me Fondacionin "Petzi". Ky libër është financuar nga Ministria e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Aftësitë bjeshkatore: Shkolla Verore" është një libër mësimi i cili u dedikohet bjeshkatarëve, kacavarëve dhe alpinistëve, të cilët dëshirojnë të përparojnë në ushtrimin e aktivitetit të tyre

të preferuar, duke përvetësuar njohuri dhe aftësi të reja. Libri është hartuar si një dokument referimi për bjeshkatarë dhe alpinistë, e posaçërisht për udhëheqës në bjeshkë dhe instruktorë të federatave dhe klubeve anëtare të Federatës Ndërkombëtare të Bjeshkatarisë dhe Alpinizmit (UIAA), anëtare e së cilës, me të drejta të plota, që nga viti 2011 është edhe Federata Bjeshkatore Alpiniste e Kosovës (FBK).

Me këtë rast, ministrja Dumoshi tha se "për mua është kënaqësi të pranohet nga ju një libër kaq të veçantë, i cili qenka më shumë se libër, pasi që tregon

saktësisht, në mënyrë të ilustruar, bukuritë e vendit tonë. Unë ju uroj për botimin e këtij libri dhe ju premtoj mbështetje edhe në të ardhmen, pasi që si Ministri e Sportit kemi synim dhe prioritet ta avancojmë sportin e vendit tonë".

Ndërkaq kryetari i Federatës Bjeshkatore e Alpiniste të Kosovës, Arben Lila, falënderoi ministren Dumoshi për pritjen dhe mbështetjen dhe tha se ky libër është mjaft voluminoz me përmbajtje të gjerë, i cili iu dedikohet bjeshkatarëve, kacavarëve dhe alpinistëve të cilët dëshirojnë të përparojnë në ushtrimin e aktivitetit të tyre të preferuar.

Rikthehet basketbolli, të mërkurën sfida e parë e 'play-out'-it

PRISHTINË, 13 TETOR - Pas një pushimi shtatëmuor, rikthehen garat në basketboll. Të mërkurën do të zhvillohet ndeshja e parë e 'play-out'-it ndërmjet AS Prishtinës dhe Trepçës. Takimi do të zhvillohet në palestrën "Don Bosko" nga ora 17:00, ndërsa ndeshja e kthimit zhvillohet të shtunën në Mitrovicë, ku do të përcaktohet se kush do të garojë në elitën e basketbollit në edicionin e ri.

Trepça edicionin e kaluar përfundoi në vendin e shtatë të Superligës, kurse AS Prishtina ishte e dyta në Ligën e Parë dhe do të ballafaqohen në 'play-out'.

Basketbollisti me përvojë i Trepçës, Besnik Azemi, ka thënë se këtë ndeshje e kanë marrë seriozisht. "Ndeshjet e play-out-it i kemi marrë shumë seriozisht dhe jemi duke u përgatitur për këto ndeshje. Kam shpresë se do të

kalojmë me rezultat pozitiv", ka thënë Azemi për faqen zyrtare të FBK-së.

Për këtë sfidë ka folur edhe trajneri i AS Prishtinës, Valentin Spaqi. "Mendoj se ky play-out nuk është i njëjti sikur ishte në fund të edicionit të kaluar, sepse ka ndryshuar edhe ekipi. Ne luajmë me ekipin që kemi momentalisht dhe jo atë të edicionit të kaluar, prandaj nuk është njëjtë. Kurse sa i përket



rivalitetit, jemi të pabarabartë, sepse Trepça ka bërë investime dhe përforsime të reja, në mesin e tyre edhe tre lojtarë të huaj. Nga skuadra jonë janë larguar disa lojtarë kyç nga skuadra, megjithatë

ne do ta japim maksimumin. Trepça është super favorite, por ne do ta japim maksimumin në këto ndeshje", është shprehur Spaqi për faqen zyrtare të FBK-së.

Kjo ndeshje dhe të gjitha të tjerat në vazhdim do të zhvillohen në masa të rrepta dhe duke respektuar rregullat anti Covid-19. Në palestër duhet të jenë maksimumi 50 persona nga të dyja skuadrat dhe zyrtarët e tjerë.



Kompania Rajonale e Ujësllësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

Kompania Rajonale e Ujësllësit Gjakova, Sh.A, duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenit 4 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/ 2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik shpall:

KONKURS

Titulli i Pozitës- Specialist/e në Nj. e Buxhetit dhe Planifikimit Financiar

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar/ Puna Provuete gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës/ Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës :

- Analizon informacionin financiar (p.sh. të hyrat, shpenzimet dhe menaxhimin e parasë) për të siguruar që të gjitha operacionet janë brenda buxhetit;
- Nen udhëheqjen e Drejtuesit të departamentit jep buxhetet vjetore për menaxherët e lartë të kompanisë;
- Shqyrton kërkesat buxhetit për miratim;
- Parashikonvevojat e ardhshme buxhetore;
- Identifikon variacione midis rezultateve financiare aktuale dhe buxhetore në fund të çdo periudhe raportuese;
- Shqyrtoni buxhetin e kompanisë për pajtueshmërinë me rregulloret ligjore nëse ka;
- Harton dhe zbaton politikën efektive të buxhetit dhe procedurat;
- Propozon përmirësimin e proceseve për zhvillimin e politikave që ndikojnë në mirëfunksionimin e aktiviteteve të kompanisë;
- Harmonizon buxhetin e Kompanisë me buxhetin i cili i dorëzohet Rregullatorit
- Çfarëdo detyre tjetër e caktuar nga KE-ja

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale.

- Përgatitja profesionale/Shkolllore- Diplomë universitare në Kontabilitet ose Financë;
- Provojë 1 vjeçare që ndërlihet me pozitën apo të ngjashme.
- Përdorues i aftë të paketës MS Office, ideale njohja e sistemeve të kontabilitetit dhe sistemeve të Informacionit.
- Njohja e dispozitave të raportimit Financiar.
- Aftësi shumë të mira në IT.
- Aftësi të mira organizative dhe koordinuese.
- Aftësi të mira komunikimi dhe të bashkëpunimit.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime.

Paga mujore: Sipas Rregullores.

Informata të përgjithshme :

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Procedura për aplikim- Aplikacioni (formulari) për konkurrim merret në Kompani dhe në ueb-faqen e Kompanisë, dhe të njëjtës i bashkëngjiten: 1. kopja e letërnjoftimit 2. Certifikata e lindjes, 3.CV-ja 4. Letër Motivuese/ kërkesë për punësim 5. kopjet e dokumentacionit të kualifikimit(kopja e noterizuar), si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati i konkurrimin është nga data: 14/10/2020 deri me 28/10/2020.
Adresa e zyrës Rr"UÇK"Nr.7,50000-Gjakovë- Kosovë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen .



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Administrim dhe Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 14.10.2020

Referenca: AAPSK - 006/2020

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1.	Audi 80 ngjyre e hirit metalike, për skrap	1 copë për skrap	161.50€		
2	Mercedes Benz 190, ngjyre e hirit metalike, për skrap	1 copë për skrap	193.63€		
3	Citroen Jumper (Kombi) ngjyre e hirit-për skrap	1 copë për skrap	341.70 €		
4	VW Golf 3 ngjyre e kaltër-për skrap	1 copë për skrap	165.75 €		
5	VW Golf 3 ngjyre vjollce- për pjese	1 copë për pjese	400.00 €		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 20.10.2020 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 20.10.2020, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në ueb faqen e AAPSK-se, në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrim dhe Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

PËR SIGURINË E JUAJ DHE PUNONJËSVE TANË, JU LUSIM QË GJATË PJESËMARRJES NË ANKAND TË MBANI MASKËN KUNDËR COVID19!

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mirella Imeroviq, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHME "Ymer Prizreni", Prizren.

► Ahmet Hamzaj, shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi", Prizren.

► Daut Gashi, shpall të pavlefshme dëftesat e diplomën e SHMLT "11 Marsi", Prizren.

► Shpresa Veliu, shpall të pavlefshme certifikatat dhe diplomën e shkollës së mesme Gjymnazi "Gjon Bukuku", Prizren.

► Valentina Miftari nga Skenderaj, shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit Ekonomik, drejtimi Banka, Financa dhe Kontabilitet të lëshuar nga Kolegji "AAB".

► Bujar Lepaja, nga Prishtina shpall te pavlefshme diplomën e SHMEJ " Hoxhe Kadri Prishtina" Prishtinë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.


► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

Nëntë vite pa më të dashurin tonë

Milazim (Ibrahim) Rexhepi


Nëntë vite kaluan e lotët asnjëherë për ty nuk pushuan. Kjo datë mbjell trishtim në zemrat tona, 14 tetori i mallkuar. Këto stinë të zymta pa ty. Vite të plota në mungesën tënde e mall për zërin tënd të dashur. Gjithmonë i pa harruar me dashurinë tënde të pa shterrueshme. Mallkuar qofshin ata që të privuan ty nga jeta e ne na dogjën. Të përkujtojmë me mall e gjithë familja Rexhepi, Banullë – Lipjan.



Sot u bënë nëntë vite që u ndamë nga gjysma jonë, babi!

Milazim (Ibrahim) Rexhepi

Sot, babi nëntë vite pa ty, duket si një jetë e tërë pa ty. Nuk mjafton asgjë që ne ta shuajmë mallin tonë për ty, sot e përjetë. Vite pa të përqaftuar e vite pa ta dëgjuar zërin tënd. Kemi mall të themi baba, asgjë më me vlerë sesa kujtimet me ty. Ne lutemi dhe do të lutemi gjatë tërë jetës për ty, atje në Parajsë. Ti tani më nuk je fizikisht me ne, por gjithmonë do të jesh në zemrat tona. Të duam shumë vajzat e babit, Lea e Rona!





ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

